Deklarata e Airlie-t

Përfaqësues të komuniteteve serbe dhe shqiptare të Kosovës u takuan së bashku në Airlie të Virginias, më 21-23 korrik 2000, me ndihmën e Institutit të Paqës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky takim pasoi takimet e mëparshme të mbajtura më 9-13 shtator 1999 në Lansdowne, të Virginias, me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar, më 10-12 dhjetor 1999 në Sofje të Bullgarisë, me përfaqësuesit e komunitetit serb, si dhe më 3-6 maj 2000, me përfaqësuesit e të dy komuniteteve që jetojnë në rajonin e Gjilanit, në Kosovë. Këto takime të mëherëshme patën për rezultat deklaratat që nxjerrin në pah shumë elemente të përbashkëta për një vizion për të ardhmen e Kosovës dhe hapat drejt realizimit të këtij vizioni.

Në takimin e Airlie-t, përfaqësuesit e komunitetit serb dhe shqiptar bënë përpjekje për të identifikuar hapat e veçantë që mund të ndërmerren bashkërisht nga pjesëtarët e të dy komuniteteve për të filluar kalimin nga fjalët e guximshme të këtyre deklaratave në arritje të vërteta në terren në Kosovë. Përfaqësuesit u zotuan se me t'u kthyer në Kosovë, ata do të vazhdojnë procesin e filluar në Airlie.

Në takimin në Airlie, si shqiptarët ashtu edhe serbët u përballën me njëri-tjetrin në frymën e të kërkuarit bashkërisht të hapave pozitive që mund të ndërmerren në drejtim të arritjes të një ujdie paqësore, pavarësisht nga dhimbjet dhe vuajtjet e mëdha për shkak të konflikteve të kaluara. Disa nga këto plagë janë aq të freskta e të thella sa e bëjnë të vështirë të vazhdohet me këto hapa pa patur më shumë kohë për shërim, më shumë prova për një ballafaqim të të dyja palëve me këto dhimbje, si dhe më shumë afrim në drejtim të njëri-tjetrit në frymën e ndarjes së bashku dhe mirëkuptimit të vuajtjeve të kaluara.

Përfaqësuesit njohin se të dy komunitetet e tyre janë vetëm në fillim të një rruge të gjatë. Kjo rrugë duhet të fillojë duke u marrë me realitetin e ditës së sotme. Për serbët, kjo do të thotë që ata njohin se do të duhej të punojnë me shqiptarët dhe të tjerët për të ndërtuar institucione demokratike dhe shoqëri demokratike në Kosovë. Për shqiptarët, kjo do të thotë se ata njohin se serbët dhe të tjerët duhet të kenë të drejta dhe mbrojtje të barabartë.

Duke njohur se si shqiptarët ashtu edhe serbët duhet të ecin përpara për hir të fëmijëve dhe fëmijëve të fëmijëve të tyre, si dhe të shoqërise së tyre, të dy komunitetet i afrohen njëri-tjetrit me mirëbesim për të tejkaluar dhimbjen dhe për t'u bashkuar me të gjithë ata që shprehin vullnetin e mirë, të cilët i përkushtohen ndërtimit të paqes dhe demokracisë në Kosovë. Pikërisht për këtë arsye, ata iu zotuan njëri-tjetrit që të ndërmarrin hapat që u vunë në pah në këtë dokument.

Zgjedhjet: Zhvillimi i demokracisë në Kosovë meriton përparësinë më të madhe, dhe të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se zgjedhjet e lira janë një element kyç në këtë proces. Pozicionet e të dy komuniteteve mbi zgjedhjet janë përshkruar si më poshtë:

- **Pikëpamjet shqiptare:** Përfaqësuesit shqiptarë këmbëngulën për pjesëmarrje të plotë të komunitetit serb në regjistrimin dhe votimin për këshillat komunale në zgjedhjet e këtij viti. Ata vunë në pah se

pjesëmarrja në procesin elektoral do të ofrojë prova për përkushtimin e serbëve për një Kosovë të lirë dhe demokratike. Ata gjithashtu vunë në pah se gjatë procesit elektoral do të ketë vështirësi qarkullimi në disa pjesë të Kosovës.

- **Pikëpamjet serbe:** Ndërkohë që njohin nevojën për zgjedhje, përfaqësuesit serbë theksuan se për serbët nuk janë krijuar kushtet që ata të marrin pjesë në to. Ata nxorrën në pah se komuniteti serb ende nuk ka liri të plotë jetese e qarkullimi, ndërkohë që shumë të tjerë mbeten të zhvendosur jashtë Kosovës.

Me përfundimin e regjistrimit, vetëm një numër i vogël votuesish të mundshëm serbë janë regjistruar. Andaj, ka shumë të ngjarë se zgjedhjet komunale do të zhvillohen pa një pjesëmarrje domethënëse nga ana e serbëve.

Të gjithë përfaqësuesit u pajtuan se këshillat komunale në Kosovë duhet të përfshijnë të gjitha grupet etnike. Ata vunë në dukje pushtetin e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (SRSG) për të bërë emërime në këshillat komunale. Të gjithë u pajtuan se të emëruarit do të duhej të jenë nga komunat ku janë emëruar. Megjithëse shqiptarët në takimin e Airlie-t e bënë të qartë se kjo alternatåivë e emërimeve nuk është optimale, ata ishin të gatshëm që të pranonin përfaqësues të emëruar serbë. Të gjithë përfaqësuesit në takimin e Airlie-t u pajtuan që të respektojnë legjitimitetin e zgjedhjeve dhe të rezultateve elektorale nëse shpallen të lira dhe të drejta nga SRSG-ja.

Mediat: Mediat e lira janë të një rëndësie thelbësore për zhvillimin demokratik. Të gjithë përfaqësuesit në takimin e Airlie-t u pajtuan se mediat mund dhe do të duhej të punojnë së bashku për të parandaluar dhunën dhe për të nxitur bashkëjetesën. Gazetarë pjesëmarrës në takimit u pajtuan që të bashkëpunojnë mbi baza profesionale dhe të shkëmbejnë informacionin. Ata u zotuan që të bëjnë përpjekje për një gazetari profesioniste, për të respektuar vlerat demokratike dhe rregullat e mirësjelljes, si hapa drejt vet-rregullimit të mediave.

Një përfaqësues i OSBE-së i njohu përfaqësuesit me masat që po ndërmerren për pajisjen me leje të mjeteve të informimit që veprojnë në Kosovë. Ata u pajtuan se Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (SRGS) do të duhej të ndërmarrë masa për të parandaluar futjen në Kosovë të mediave të shtypit, radios dhe televizionit që përdorin gjuhën e urrejtjes. Përfundimisht, krimi i gjuhës së urrejtjes duhet të përfshihet në versionin përfundimtar të kodit civil dhe penal të Kosovës dhe të ndiqet penalisht nga sistemi gjyqësor. Në të njëjtën kohë, përfaqësuesit pranuan pushtetin e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (SRSG) për të kundërvepruar ndaj atyre që përdorin gjuhën e urrjetjes. Përfaqësuesit tërhoqën vëmendjen për sa i përket krijimit të një shërbimi lajmesh shumëgjuhësh në Kosovë dhe u zotuan të nxisin njoftime nga secili grup etnik për grupet e tjera në komunitetin e Kosovës.

Shoqëria civile: Dekada të tëra tensioni dhe konflikti e kanë lënë shoqërinë civile në Kosovë thellësisht

të përçarë e të dobët. Të gjithë njohën rëndësinë e nxitjes së zhvillimit të elementeve shumë-etnike brenda shoqërisë civile. Plagët e së kaluarës së afërt ende janë tepër të thella për të lejuar gjë tjetër veçse mundësisë së fillimit të një procesi më se të nevojshëm të pajtimit. Përfaqësuesit u pajtuan për rëndësinë që ka hedhja e shikimit më guxim drejt së ardhmes dhe gjetja e mënyrave për të evidencuar përvojat e tyre në konflikt. Ata u pajtuan se takimi mes tyre në *Airlie House* ishte një hap fillestar ambicioz në dialog. Ata u zotuan se pas kthimit në Kosovë, do të veprojnë bashkërisht nëpërmjet mediave për të nxitur më tej vëmendjen ndaj këtij fillimi të ri.

Siguria. Ne pajtohemi që të ndërmarrim një nismë të re – një Fushatë Kundër Dhunës - që do të përfshijë elementet e mëposhtme:

- Ne pajtohemi nga sot për një Pakt Kundër Dhunës për të nxitur tolerancë, për të dënuar dhunën, për të parandaluar keqpërdorimin e çeshtjeve etnike, si dhe për të mundësuar integrimin fizik dhe pjesëmarrjen politike të të gjithëve.
- Fushata do të përfshijë një Ditë kundër Dhunës, në një datë të caktuar nga Këshilli Tranzitor i Kosovës - një datë para fillimit të fushatës elektorale - kur udhëhëqësit kosovarë do të dalin publikisht së bashku në Prishtinë dhe më vonë në qendra të tjera në Kosovë.
- Këta udhëheqës do të vizitojnë komunitete lokale anembanë Kosovës për të nxitur Fushatën Kundër Dhunës dhe do të mundohen t'i bindin qytetarët se ka ardhur koha për riintegrim.
- Ne do të vendosim dialogje shumë-etnike të qytetarëve për çeshtje praktike me interes për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe do të kërkojmë që UNMIK-u dhe KFOR-i të ofrojnë sigurinë e duhur.
- Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet eliminimit të urrejtjes etnike dhe dhunës nga fëmijët dhe midis tyre dhe parandalimit të shfrytëzimit të fëmijëve për nxitjen e dhunës.
- Ne u pajtuam që të kërkojme lirimin e të burgosurve dhe të personave të rrëmbyer dhe vendndodhjen e personave të humbur.
- Një fushatë nga mediat do të jetë pjesë përbërëse e kësaj përpjekjeje.

Për të zvogëluar fuqinë e ekstremistëve, ne:

- kërkojmë që pjesëtarët e të gjithë komuniteteve të dorëzojnë armët pa leje dhe i bëjmë thirrje KFOR-it dhe UNMIK-ut që të konfiskojë të gjitha armët pa leje.
- i bëjmë thirrje KFOR-it dhe UNMIK-ut që t'i ruajë dhe kontrollojnë në mënyrë më efikase të gjitha hyrjet në Kosovë.
- kërkojmë që UNMIK-u të veprojë menjëherë për ngritjen e një sistemi funksional gjyqësor dhe të burgjeve,
- u kërkojmë pjesëtarëve të komuniteteve tona që të identifikojnë autorët e krimit, përfshirë edhe krimet e kryera ndaj grupit tjetër etnik.
- kërkojmë që UNMIK-u të krijojë një linjë të sigurt (linjë urgjence, apo ngjashëm), për qytetarët,

për të ndihmojnë në identifikimin dhe kapjen e autorëve të krimit.

- mbështesim Gjykatën e Hagës dhe gjykatat penale në punën e tyre kundër krimeve ndaj njerëzimit dhe të gjitha krimeve të tjera në Kosovë dhe kërkojmë që t'i nxjerrim përpara drejtësisë të gjithë ata që janë përgjegjës, brenda apo jashtë Kosovës.
- këmbëngulim në shpërndarjen e menjëherëshme të të gjitha strukturave paralele qeverisëse dhe të sigurisë.

Kthimet: Për të lehtësuar kthimin e njerëzve të zhvendosur dhe të refugjatëve në shtëpitë e tyre, ne:

- njohim se kthimi është një e drejtë themelore dhe është thelbësore për të ardhmen e Kosovës, dhe ne do t'i nxisim më tej këto kthime, në pajtim më të drejtën ndërkombëtare, me deklarata dhe veprime të qarta, dhe jo të dykuptimshme brenda komuniteteve tona përkatëse.
- bëjmë thirrje që të largohen njerëzit që ndodhen ilegalisht në Kosovë, veçanërisht ata që kanë zënë shtëpitë e të tjerëve,
- inkurajojmë vizitat e organizuara të personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre, nën kujdesin e UNMIK/KFOR-it, dhe zotohemi se do të bashkëpunojmë në këtë drejtim,
- zotohemi se do t'i përgatisim komunitetet lokale për kthimet e pjesëtarëve të grupit tjetër etnik,
- inkurajojmë shtimin e komunikimit midis të të zhvendosurve dhe vendit të tyre të prejardhjes,
- këmbëngulim që UNMIK-u dhe KFOR-i të ndërmarrin përpjekje të reja në mënyrë që të ofrojnë një siguri më të madhe për realizimin e kthimeve dhe të rrisin ndihmat për rindërtim dhe ringjallje ekonomike në ato komunitete që pranojnë kthimet,
- ftojmë komunitetin ndërkombëtar që të inkurajojë kthimet, duke u siguruar komunave që i organizojnë ato efektivisht mjetet e duhura ekonomike për t'i mbështetur.

KFOR-i dhe UNMIK-u janë përgjegjës për sigurinë publike, ligjin e rendin civil, në bazë të marrëveshjeve aktuale të pasluftës, në përputshmëri me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përfaqësuesit u pajtuan se niveli aktual i sigurisë dhe i lirisë së qarkullimit në Kosovë nuk është i pranueshme. Është i nevojshëm një model i ri i sigurisë dhe i zbatimit të ligjit. Vendosja e këtij modeli të ri do të jetë një rrugë dykahëshe midis qytetarëve të Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar. Nga ana tjetër, komuniteti serb dhe ai shqiptar duhet të bashkëpunojnë për të bërë atë ç'është e mundur për të shtuar sigurinë, si vetë nga ana e tyre, ashtu edhe në bashkëpunim me UNMIK-un dhe KFOR-in. Një sërë hapash në këtë drejtim tashmë janë përshkruar. Nga ana tjetër, komuniteti ndërkombëtar duhet t'i tejkalojë dallimet e veta, në mënyrë që UNMIK-u dhe KFOR-i të mund të ndërmarrin masa shumë më të fuqishme për të kryer përgjegjësite e tyre ndaj sigurisë dhe zbatimit të ligjit. KFOR-i dhe UNMIK-u duhet të angazhohen në përpjekje të bashkërenditura për të afirmuar pushtetin e tyre në mënyrë të barabartë në të gjitha pjesët e Kosovës, përfshirë kundërshtimin e ndikimit të regjimit të Millosheviqit në Kosovë. UNMIK-u dhe KFOR-i duhet t'i ndalojnë plotësisht të gjitha forcat e paautorizuara të sigurisë që veprojnë në Kosovë, qofshin me origjinë nga Kosova apo jashtë saj.

Përfaqësuesit kërkojnë që komuniteti ndërkombëtar të qendrojë i përkushtuar ndaj së ardhmes së Kosovës. Por, ata njohin se komuniteti ndërkombëtar nuk do të mbështesë një Kosovë të spastruar prej disa komuniteteve të saj etnike. Përkundrazi, të gjitha këto komunitete duhet të punojnë së bashku për të ndërtuar një Kosovë shumë-etnike, ku respektohen të drejtat e të gjithë qytetarëve të saj.

Përfaqësuesit që morën pjesë në takim:
Mahmut Bakalli
Ethem Ceku
Father Kirilo Djurkovic
Vjosa Dobruna
Baton Haxhiu
Arben Hoxha
Ylber Hysa
Skender Hyseni
Father Sava Janjic
Januz Januzaj
Kaqusha Jashari
Petar Jeknic
Naim Jerliu
Margarita Kadriu
Aferdita Kelmendi
Nekibe Kelmendi
Slavisa Kolasinac
Mark Krasniqi
Ismajl Kurteshi
Eqrem Kryeziu
Naim Maloku
Esat Marovca
Basri Musmurati
Dragan Nikolic
Sonja Nikolic
Randjel Nojkic
Pajazit Nushi
Luljeta Pula-Beqiri
Bishop Artemije Radosavljevic
Nenad Radosavljevic
Dusan Ristic
Slavisa Ristic
Bajram Rexhepi
Ibrahim Rugova
Edita Tahiri
Hashim Thaci
Rada Trajkovic
Father Petar Ulemek
Dragan Velic
Ariana Zherka